

Studentë të kurseve të anglishtes



Studentë të kurseve të gjermanishtes



26 tetor 1996, në Universitet...

# Programi

1. Përshëndetje nga pjesëmarrës në ceremoni, që duan të flasin për Zefin e punën e tij.

2. *Një jetë në përpjekje për mbijetesë dhe në shërbim të dijes* – film dokumentar kushtuar Z.Dushit

3. Dorëzimi i titullit "**Mirënjohja e Qytetit**" nga Kryetari i Këshillit të Bashkisë Shkodër- Z.Xhemal Bushati

**BASHKIA E SHKODRËS**
**KËSHILLI I BASHKISË**

**UNIVERSITETI I SHKODRËS**
"Luigj *Gurakuqi*"

# FTESË

**Z.**___________________

Ditën e **premte**, më **18 mars 2016,**

ora **11.00**

në

Auditorin **"Walter Höflechner"** të Bibliotekës së Universitetit **"Luigj Gurakuqi"**, zhvillohet ceremonia e dhënies së titullit

**"Mirënjohja e Qytetit"**

**zotit ZEF DUSHI**

**Ftoheni të merrni pjesë**



Me Z. Scpalinger, ambasador i parë i Austrisë në Shqipëri



Me Prof. Höflechner



Me Shoqatën e miqësisë Shqipëri-Austri



# ZEF DUSHI

## Një jetë në përpjekje për mbijetesë dhe në shërbim të dijes.



Kete shkollë a hapa me 5 Prill 1992
Duke dashtë që ndihmoj rininë e
Shkodres dhe te zones së veriut për të
Perparuar sado pak drejt Europes gofte
me kulturë dhe përparimin e popullit
shqiptar në fushen e arsimit dhe
te kulturës botnore
Të ndihmosh te vaifrit osht ullzimi
i Zotit. Nuk merrem me politike
se duhet te dijsh me rrejt, dhe natyra
ime ka thënë kete veti. Në jeten teme
jam rritur

Zef Dushi u lind me 18 mars 1935 në një familje intelektuale. Babai i tij qe diplomuar në Akademinë Ushtarake të Vienës. Shërbeu në Shqipëri deri në vitin 1924 dhe bashkëpunoi ngushtë me Luigj Gurakuqin dhe Hasan Prishtinën. Pati dy djem dhe një vajzë. Vdiq më 1944, pasi i kishin vdekur e shoqja dhe vajza. Zefi me vëllain disa vjet më të madh mbetën jetimë. I vëllai antikomunist iku në Jugosllavi. Zefi u shkollua në Shkodër dhe pastaj me vështirësi punoi për bukën e gojës, në disa kantiere. I ftuar nga vëllai për të bashkëpunuar, iku në Jugosllavi. Një ditë u kthyen, por u kapën në kufi. I vëllai u dënua me pushkatim, ndërsa Zefi, pas torturave në qeli, bëri 12 vjet burg. Kur doli nga burgu, punoi në ndërtim. U martua, por më 1999 i vdes gruaja.

Ndryshimin e sistemit e priti me gëzim. Tashmë kishte mundësi të punonte i lirë, por nuk mbajti urrejtje në shpirt. Me nismën e tij dhe me qëllimin e mirë që t'u lehtësojë të rinjve komunikimin në gjuhë të huaja, hapi kurse për të rinjtë që vazhdonin shkollën e lartë. Pa mjete financiare, por vetëm me ndihmën e ambasadave gjermane dhe austriake hapi më 5 prill 1992 kurset e para të gjuhës së huaj. I mbajti të hapura dhe të suksseshme për 21 vjet, duke qenë kurdoherë në krye të tyre, në shi e në të ftohtë, shpesh në përballje me keqdashës të dijes. Deri me 2013 kurset e tij i kishin përfunduar më shumë se 5000 kursantë, studentë e punonjës të administratës. Kursantët e tij të parë të përgatitur në kurset e tij të gjermanishtes qenë garanci për hapjen e Degës së Gjermanistikës në shtator 1996. Ata të gjithë fituan konkursin e parë shumë rigoroz të organizuar nga Universiteti i Gracit.Me punën e tij fitoi admirimin e ambasadave të huaja, e të personaliteteve shtetërore të huaja. Albumi me fotografi, me shpjegimet e kujdesshme, janë dëshmi e këtyre lidhjeve. Nuk pati rrogë, nuk mori tituj shkencorë që të japin mundësi të rritjes së saj, nuk kreu detyrat shtetërore të detyrueshme, por dha një kontribut të vyer për qytetin e më tej, që nuk e kishte detyrim, por që ia ndjeu shpirti i tij. Sot ai është në moshë të thyer dhe ka mundësi të shohë vetëm me sytë e zemrës.